

EDUART CAKA

**TIPOLOGJI TË NJË QYTETI KUFITAR: DURRËSI
GJATË DY SHEKUJVE TË PARË TË SUNDIMIT OSMAN
(SHEK. XVI-XVII)**

Hyrje

Periudha osmane zë një vend të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë. Kjo, jo vetëm për harkun shekullor prej pesë shekujsh të pranisë së osmanëve në këtë hapësirë por më së shumti edhe për faktin se dokumentacioni arkivor i kësaj periudhe na jep të dhëna shumë të rëndësishme për historinë e shqiptarëve. Ky element ka qenë edhe njëri prej shkaqeve që periudha osmane të jetë vazhdimisht në fokusin e historianëve shqiptarë dhe të huaj. Për rrjedhojë, lexuesi i thjeshtë dhe ai i kualifikuar tashmë ka në dorë një korpus të konsiderueshëm me studime mbi periudhën osmane të Shqipërisë.

Duhet theksuar se studimet osmane kanë ndjekur të njëjtën trajektore me periudhat e tjera që janë tematikë e historiografisë shqiptare. Kështu, duke nisur qysh nga mesi i shek. XX, vëllimet dokumentare dhe monografite e përgatitura nga studiuesit shqiptarë mbi këtë kohë janë përqendruar më së shumti në aspektet ushtarake, politike e ekonomike. Për rrjedhojë, tematika të tjera si kultura, shoqëria, arti, feja etj., kanë mbetur në hije. Në këtë kontekst, pa u zgjatur më shumë në problematikat e studimeve osmane në Shqipëri, vlen të përmendet fakti se njëra prej mungesave më të mëdha që hasim, është edhe numri shumë i vogël i studimeve që janë kryer mbi qytetet shqiptare gjatë sundimit osman. Parë nga ky këndvështrim, i vetmi punim i mirëfilltë që na del përpara mbi historinë e qyteteve shqiptare gjatë kësaj periudhe, është studimi i Ferit Dukës ku paraqiten me detaje dhe brenda një metodologjie të gjithë komponentët përbërës të qytetit shqiptar brenda kontekstit osman.¹

¹ Ferit Duka, *Berati në kohën osmane*, Tiranë: Toena, 2001. Një punim tjetër që duhet përmendur është edhe ai i Zija Shkodrës me titull *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, i botuar në vitin 1984, porse ky studim përqendrohet më shumë në aspektin ekonomik të qyteteve të ndryshme shqiptare.

Pikërisht për arsyet e përmendura më sipër, kemi tentuar që përmes këtij artikulli të ndalemi tek dy shekujt e parë nën sundimin osman të Portës së Adriatikut dhe njëherazi një rës prej ndalesave më të rëndësishme të rrugës së famshme *via Egnatia*, Durrësit, rreth të cilit, fatkeqësisht, ende nuk kemi një studim të mirëfilltë të karakterit historik, në lidhje me periudhën osmane. Pa u zgjeruar në panoramën e përgjithshme, në këtë artikull jemi përpjekur të përqendrohemi thelbësisht tek qyteti i Durrësit duke u ndalur tek pushtimi i tij, aspekte të sigurisë e problematikave të rendit që kishte ky qytet deri në fillimet e shek. XVIII, si dhe marrëdhëniet me hapësirat përreth por dhe ato më përtej Adriatikut në kontekstin e zhvillimit ekonomik. Përveç studimeve të kryera nga studiues të fushës mbi periudhën në fjalë, kemi konsultuar vëllimet dokumentare të përgatitura nga Zamputi e Pulaha, vëllime të cilat përmbajnë dokumente të arkivave të Stambollit, Venedikut, Vatikanit, Raguzës etj. Gjithashtu jemi përpjekur të paraqesim edhe dokumentacionin më të fundit të zbuluar në Venecia e Stamboll rreth kësaj periudhe të panjohur të Durrësit² duke u munduar të hedhim dritë gjatë dy shekujve të tij të parë nën sundimin osman.

Marrja e Durrësit prej osmanëve

përceptazi dhe, përgjithësisht me një apo dy fjali, nga historianët më në zë të Perandorisë Osmane si Hammeri apo Jorga, por edhe nga autorët venecianë të kohës si dhe historiografia e sotme shqiptare.³ Aktualisht, tekstet më të plota në lidhje me këto ngjarje janë disa pasazhe të kronistëve osmanë të përkthyer nga Selami Pulaha e të botuara në vëllimin e përgatitur prej tij mbi luftën shqiptaro-turke të shek. XV.⁴

² Më konkretisht, bëhet fjalë për vëllimet dokumentare të botuara nga Maria Pia Pedani në Venecia mbi dokumentacionin që flet për osmanët në arkivat veneciane por, edhe urdhrat perandorakë osmanë të dalë përmes *Mühimme Defterleri*, ku një pjesë e regjistrave të këtij korpusi janë botuar në këto dy dekadat e fundit prej Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Turqisë.

³ Për një histori të gjithë bregut shqiptar gjatë periudhës paraosmane dhe veçanërisht të Durrësit shih: Oliver Jens Schmitt, *Arbëria Venedike (1392-1479)*, përkthyer nga Ardian Klosi, Tiranë: Fjala Publishing, 2014.

⁴ *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV (Burime osmane)*, përgatitur për shtyp nga Selami Pulaha, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1968. Për më shumë detaje mbi autorë e historianë të periudhës osmane të cilët e kanë trajtuar çështjen e pus

Në mendimin tonë, hapi i parë drejt marrjes së Durrësit ishte hedhur qysh në vitin 1466 me ndërtimin e kalasë së Elbasanit dhe kthimin e këtij vendbanimi të ri në një qendër sanxhaku. Në të vërtetë, siç duket edhe Venediku e kishte kuptuar rrezikun, prandaj senati i Republikës së Shën Markut i kërkonte Skënderbeut që ta sulmonte këtë ndërtim që po bënin osmanët.⁵ E kemi të pamundur ta themi me siguri nëse Elbasani u ndërtua si një pikë shtytëse për të mësyre drejt bregdetit përveç Krujës, e cila ishte edhe qendra e shqiptarëve me në krye Skënderbeun-, në rastin konkret, Durrësit. Por, disa të dhëna që na vijnë nga kronistët osmanë të kohës, na shtyjnë për ta marrë në konsideratë edhe një hipotezë të tillë. Kështu, Idris-i Bitlisi shprehet se, të gjithë sulltanët që patën ardhur në këto anë kishin dalë në përfundimin se marrja nga deti e Durrësit ishte e pamundur si arsye e flotës së fuqishme të armikut që lundronte në detin përballë qytetit.⁶ Pas vdekjes së Skënderbeut e rënies së Krujës si dhe pas pushtimit të Shkodrës, tanimë

të arritur skajin më perëndimor të Rumelisë, Durrësin.

Duke iu referuar të dhënave që na japin kronistët osmanë si Bitlisi por edhe Hoxha Sadeddini e Aliu, të cilët e përshkruajnë ngjarjen në fjalë me pak diferenca porse Bitlisi jep më shumë detaje, sanxhakbeu i Elbasanit, Mehmet Beu kishte bërë një përgatitje të gjatë përpara se të organizonte sulmin në drejtim të kalasë së Durrësit. Ai kishte mbledhur informacione të detajuara si mbi planimetrinë e fortesës, ashtu edhe mbi trupat mbrojtëse dhe kapacitetin e tyre luftarak. Më pas, duke mbledhur edhe trupa ndihmëse prej sanxhaqeve të tjera, më 17 gusht 1501 kishte realizuar sulmin drejt kalasë në fjalë duke arritur të marrë Durrësin.⁷

*Studia Albanica Monacensia. In memoriam
Georgii Castriotae Scandergei 1468-1968*, vol. VIII, München: 1969, f. 23-31.
(Artikull i përkthyer në gjuhën shqipe me t

-III-371.

Në këtë punim, ne i kemi referuar versionit të përkthyer nga Veniamin Dashi).

⁵ Për më shumë të dhëna mbi reagimin e Venedikut për ngritjen e kalasë së Elbasanit

Studime historike, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, nr. 1-2, Tiranë: 2016, f. 101-103.

⁶ *Lufta shqiptaro-* , f. 179.

⁷ *Po aty*. Ndërsa Kissling i referohet artikullit të Jirecek mbi Durrësin kur e jep këtë datë. Shih: H. Kissling, , f. 1.

Kronistët osmanë shprehen se Mehmet Beu i kishte ndarë trupat e tij, duke nxjerrë përpara një pjesë të tyre, ndërsa pjesën tjetër të ushtrisë e kishte mbajtur të fshehtë. Duke parë trupat përballë, mbrojtësit e kalasë

armikun. Në vijim trupat osmane zgjodhën taktikën e tërheqjes, ndërsa ato mbrojtëse të kalasë kaluan në ndjekje të tyre. Pikërisht në këtë kohë, pjesa e fshehur e ushtrisë osmane kishte kaluar në marshim duke i prerë udhën e hyrjes brenda kalasë trupave mbrojtëse, të cilët po ndiqnin nga pas pjesën e ushtrisë osmane në tërheqje. Duke shfrytëzuar rastin e krijuar, pjesa e ushtrisë osmane, e cila u kishte dalë mbrojtësve të kalasë pas krahëve, arritën të hynë në ndërtesë përpara tyre duke bërë të mundur edhe pushtimin e saj.⁸

Të habit fakti se si kalaja kishte rënë në duart e osmanëve kaq lehtë, pa rrethime, beteja e bllokime. Në fakt, përgjigjen e gjejmë tek Kissling, e cila i referohet ditareve të Sanutos që shprehet se, megjithëse Durrësi kishte një pozitë strategjike, numri i banorëve dhe i mbrojtësve të kalasë ishte shumë i vogël. Në mars të vitit 1501 ishin kërkuar 40 stratiotë për të ardhur e ndihmuar në ruajtjen e qytetit, i cili ndihej gjithnjë e më shumë i kërcënuar prej osmanëve por, Venediku kishte vendosur të dërgonte këtu vetëm 25 ku, edhe këta nuk kishin dëshirë të vinin për të shërbyer në këtë qytet. Në këtë situatë, kapedani kishte tentuar të bëjë disa rregullime në

9

Nga narrativat osmane por edhe ato veneciane del në pah një element që vlen të merret në konsideratë. Ajo është gjendja e rrënuar e kalasë së Durrësit ku, siç e pamë edhe më sipër, kapedani venecian kishte dashur ta rregullojë me qëllimin për të realizuar mbrojtjen e qytetit. Një detaj tjetër që e përforcon këtë mendim na vjen edhe nga përshkrimi i Bitlisit, sipas të cilit, fill pas pushtimit të qytetit, sulltani kishte nxjerrë ferman për ndërhyrje në kala. Për arsye se paraqet situatën demografike të qytetit por edhe atë të kalasë, si dhe ndërhyrjet që osmanët do të bënin, pasazhin e Bitlisit po e paraqesim të plotë:

Meqenëse qyteti-kështjellë [i vjetër] ishte shumë i gjerë, [fermani] urdhëronte që, po të ishte se për shkak të popullsisë së pakët ai [qytet] mbetej [pjesërisht] i pabanuar, duke marrë kështu një pamje të

⁸ *Lufta shqiptaro-* , f. 180-181.

⁹ H. Kissling, *Pushtim* , f. 2-3.

*shëmtuar, simbas nevojës muret origjinalë mund të reduktoheshin gjer në një të tretën që kështu [qyteti] të mund të mbahej e të mbrohej me pak ushtarë. Pjesa që u veçua për fortesë me rastin e kësaj ndarjeje u fortifikua shumë, kurse materiali i shtëpivët që kishin qenë në kështjellë u hodh jashtë, kështu në këtë vend mund të ngrinte shtëpi cili të donte nga banorët. Zmadhimi dhe zgjerimi që fitoi ky qytet kështjellë me këtë ndarje e forcim mund të kuptohet [nga fakti i mëposhtëm]: Meqenëse pranë murit që ndante [tashti] një të tretën e veçuar për fortesë kishte material ndërtues si gurë të punuar etj., që gjendeshin në themelet e vjetër [të fortesës], u sollën mjeshtrë të zotë ndërtimi nga të gjitha viset e Rumelisë...*¹⁰

Nga të gjitha këto sa u thanë, ishte mëse e qartë se Durrësi tanimë kishte mbetur vetëm një kështjellë bregdetare¹¹ me një numër të vogël banorësh, e cila, përpos problemeve të tjera dhe pushtimit që sapo kishte kapërcyer, do të prekej edhe nga murtaja. Kështu, në tetor të vitit 1502, proveditori i Lezhës, Antonio Boni lajmëronte Venedikun se në Durrës kishte rënë murtaja, se osmanët kishin ikur nga qyteti dhe se vetëm me gjashtë anije ishte e mundur rimarrja e qytetit.¹² Siç e theksojnë burimet, kjo kërkesë e tij nuk ishte aprovuar prandaj Durrësi do të mbetej tek osmanët.

Siç duket edhe nga përpjekjet tejet minimale për ta mbrojtur qytetin, por edhe gjendja e rrënuar në të cilin ai gjendej, na bën të kuptojmë se në njëfarë mënyre Venediku kishte hequr dorë nga ky qytet. Kjo, si rrjedhojë e fuqizimit të osmanëve në brendatokë duke shtënë në dorë të gjithë hapësirën e brendshme por edhe qytete të tjera të vijës bregdetare duke e lënë Durrësin e Lezhën të rrethuara por, ndoshta edhe

përballur me osmanët pasi ajo kishte zotërime të tjera më strategjike që

osmane me qëllimin e shkëmbimit të Durrësit dhe rrethinave me ishullin e Shën Maur

¹⁰ *Lufta shqiptaro-* , f. 182.

¹¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 549.

¹² H. Kissling, , f. 4.

¹³ Siç do të vërehet edhe në vijim, Durrësi do të vijojë të mbetet objekt i tentativave

Aspekte të fizionomisë dhe demografisë së qytetit gjatë shek. XVI-XVII

Durrësi kishte kaluar nën sundimin osman në vitin 1501 për të qëndruar e varur si qendër kadillëku nga sanxhaku i Elbasanit deri në shek. XIX, kohë në të cilën u lidh me vilajetin e Shkodrës.¹⁴ Në burimet osmane emri i qytetit kalon si *Draç* ose për arsye se në fonetikën e tyre leximi i dy bashkëtingëlloreve është i vështirë. Një burim osman që flet për Durrësin fill pas kalimit nën zotërimin osman është vepra e titulluar *Kitab-* e gjeografit Piri Reis, i cili duhet ta ketë vizituar bregun e Durrësit rreth dy dekadave të para të shek. XVI duke na dhënë një hartë dhe informacione të pakta në lidhje me kalanë dhe zonën përreth.¹⁵ Në veprën e tij, Piri Reis thekson se në të dyja anët e gjirit uji është i cekët dhe se anijet e mëdha që kalojnë nga kjo pjesë duhet të përparojnë me kujdes. Sa për anijet më të vogla, ai thekson se Porto Balo (Kepi i Palit ?) është një vend më i përshtatshëm për ankorim.

Siç duket, me marrjen e qytetit, osmanët kanë bërë rregullime e

shkatërruar.¹⁶ Bëhet fjalë për një ndërhyrje në kala gjatë periudhës së sundimit të Bajezidit II, informacion të cilin e marrim prej udhëtarit dhe kronikanit të shek. XVII, Evlija Çelebiut. Ky i fundit shprehet se struktura e kalasë kishte qenë e madhe por nga luftërat e shumta ajo kishte pësuar dëmtime të shumta. Perimetrin e kalasë, Çelebiu e jep në shifrën e 5000 hapave. Sipas Çelebiut, nisur nga numri i vogël i forcave mbrojtëse të kalasë dhe nga rreziku i një sulmi që mund të vinte nga ana e detit, në kohën e Bajezidit II, pikërisht në anën lindore të kalasë ishte

¹³

, Inventario della miscellanea

Publicazioni Degli Archivi di Stato, Venezia: 1994, f. 20.


¹⁴

Michael Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri 1385-1912*, përktheu Klodiana Smajlaj, Tiranë: AIITC, 2002, f. 121.

¹⁵ Piri Reis, *Kitab-i Bahriye*, Stamboll: 1526, f. 141-143.

¹⁶ Shih: M. Kiel, *Arkitektura osmane...*, f. 121.

bërë një ndarje në perimetrin e 800 metrave brenda mureve ekzistuese.¹⁷ Pra, ishte ndërtuar një fortesë e vogël brenda kalasë së madhe e të dëmtuar. Vetë Çelebiu nuk e jep datën e ndërhyrjes në kala por, nëse do të kemi parasysh faktin se qyteti u mor prej osmanëve në vitin 1501 dhe se sulltanati i Bajezidit II përfundon në vitin 1512, rrjedhimisht dalim në përfundimin se ndërtimi në fjalë ishte kryer gjatë këtyre viteve.¹⁸



Durrësi në Kitab-

Pa u futur shumë në detaje, vlen të përmendet fakti se thuajse të gjithë raportet e autorët që i referohen qytetit të Durrësit gjatë kohës kur u mor prej osmanëve, bashkohen në faktin se përveç klimës tepër të keqe të vendit, kalaja e këtushme ka pësuar vazhdimisht rregullime, meremetime e ndryshime, të cilat kanë vijuar deri në periudhën e Pavarësisë. Pra, një proces ndërhyrjesh në kala që ka vazhduar rreth 4 shekuj. Kështu, përveç informacionit të mësipërm për ndërhyrjen në kala fill pas marrjes së qytetit, sërish brenda shek. XVI do të kemi meremetime të tjera. Nga

¹⁷ Evliya Çelebi, *Seyahatname*

¹⁸ Zija Shkodra, duke iu referuar Jorgas, shprehet se ndërhyrja e parë ishte bërë në vitin 1503 ku kishin marrë pjesë 8 deri në 10 mijë veta. Një numër i ekzagjeruar në mendimin tonë por, ajo çka ka rëndësi këtu është fakti i rindërtimit që iu bë kalasë. Shih: Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare (shek. XV-XX)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1973, f. 35.

dokumentet mësojmë se brenda të njëjtit shekull kalaja ka patur edhe meremetime të tjera. Për shembull, në fillimet e janarit të vitit 1572, hasim në një shkresë dërguar kadiut të Durrësit përmes së cilës i kërkohet të garantojë pagesën e personit të quajtur Hasan Çavush, i cili kishte ardhur këtu për të kryer meremetime në kalanë e qytetit.¹⁹

E shkuara historike si dhe pozita strategjike kishte bërë që Durrësi të gjendej gjithnjë pre e sulmeve të shumta, aspekt i cili e bënte të pafavorshëm jetesën në këtë qytet. Një element tjetër që ndikonte në mospërqendrimin e popullsisë në këtë gjeografi ishte edhe elementi klimaterik. Toka ku ishte vendosur kalaja gjendej sipër një shtrati me përqendrim të madh kripe sikurse hapësirat përreth kalasë ishin moçalishte, elementë të cilit ishin të pafavorshëm për jetesën në këto hapësira.²⁰ Madje, për të theksuar klimën e dëmshme, Hahn shprehet se:

21

Elementët e mësipërm bënin që domosdoshmërisht qyteti, në krahasim me rëndësinë e tij strategjike, të kishte një popullsi të vogël në numër.

Kiel thekson se në kohën kur qyteti u mor prej osmanëve kishte një popullsi prej rreth 1 mijë banorësh. Ai gjithashtu i referohet një raporti venecian në të cilin thuhej se në këtë periudhë në Durrës kishte vetëm 200 persona që mund të futeshin nën armë.²² Një shifër e tillë e popullsisë së qytetit përforcohet edhe nga peshkopi Marino Bizzi (Marin Bici), i cili kishte numëruar në Durrës 300 shtëpi në vitin 1610.²³ Ndërsa

19

-356) *Transkripsiyon*

Sosyal Bilimler Enstitüsü, Erzurum: 2006, f. 130

²⁰ Vizitorë dhe funksionarë perëndimorë që e kanë vizituar qytetin gjatë shek. XVII-XVIII theksojnë se malaria ishte njëra ndër sëmundjet më të përhapura këtu. Për më shumë të dhëna mbi klimën e Durrësit në këtë periudhë shih: E. Çelebi, *Seyahatname...* ... , f. 523.

²¹ Johan Georg von Hahn, *Studime Shqiptare*, përkthyer nga gjermanishtja Veniamin Dashi & Afrim Koçi, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë: 2007, f. 109.

²² ... , f. 523.

²³ Kiel na jep të dhëna të tjera në lidhje me demografinë e qytetit, përkatësisht nga Pouqueville (1699) dhe i dërguari francez Isnard (1716), të cilët jo vetëm që konfirmojnë numrin e vogël të popullsisë që jetonte në qytet por, gjithashtu na mundësojnë të krijojmë një linjë kronologjike të zhvillimit të qytetit në aspektin demografik. Për më shumë të dhëna shih: M. Kiel, *Arkitektura osmane...*, f. 122; M. ... , f. 523.

Evliaja Çelebiu, i cili e vizitoi qytetin rreth gjysmë shekulli (1670-71) më vonë na transmeton se ky vendbanim kishte 150 shtëpi.²⁴

Të dhënat e Bicit dhe të Çelebiut, me gjithë diferencën në numra, në këndvështrimin tonë mund të konsiderohen si të sakta. Një tregues i këtij aspekti janë anuarët (salname) osmanë që nisën të përpilohen gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX. Kështu, në salnamenë e vilajetit të Shkodrës, pjesë e së cilit ishte edhe sanxhaku i Durrësit, të vitit 1310 Hixhri (1892-93) Durrësi kishte një popullsi prej 4785 banorësh prej të cilëve 3018 ishin myslimanë, 1520 ortodoksë, 199 katolikë dhe 48 ishin të huaj.²⁵ Një rritje demografike mëse normale pas rreth dy shekujsh e gjysmë prej të dhënave të të sipërpërmendurve po të kemi parasysh këtu edhe rritjen galopante që do të kishte Durrësi pas gjysmës së dytë të shek. XVIII me hapjen e konsullatave të huaja.

Të dhënat që na jep Çelebiu mbartin një rëndësi të veçantë për vetë faktin se autori na informon rreth kalasë si objekt fizik por, ai gjithashtu shton edhe dije të tjera rreth aspekteve administrative, demografike, kulturore e ekonomike të Durrësit të shek. XVII. Në aspektin administrativ, Durrësi varej nga Elbasani, qytet ku ndodheshin edhe selitë e komandantëve të spahinjve dhe atij të jeniçerëve të qytetit. Ndërsa kadiu i Durrësit, sipas Çelebiut, qëndronte në qytetin e Kavajës. Siç duket, në Durrës qëndronte vetëm dizdari i kalasë, i cili sipas Çelebiut, kishte nën varësi rreth njëqind e pesëdhjetë trupa. Kalaja kishte gjithashtu njëmbëdhjetë topa të vegjël që shërbenin për mbrojtjen e saj.

Pas të dhënave burimore mbi aspektet gjeografike e demografike të qytetit, tani le të futemi më në brendësi të tij duke hedhur vështrimin mbi institucione, objekte e komponentë të tjerë të jetës politike, administrative, shoqërore e kulturore të qytetit. Sigurisht që në qendër të këtyre zhvillimeve qëndronte kalaja e Durrësit. Çelebiu na jep të dhëna edhe mbi aspektin fizik të kalasë së Durrësit në kohën kur ai e vizitoi këtë qytet. Përveç informacionit për ndërtimin e një fortese brenda kalasë gjatë periudhës së Bajezidit II, Çelebiu na rrëfen edhe rreth ndërtesave të tjera që ai kishte parë brenda kalasë. Kështu, ai na transmeton se kalaja kishte

²⁴ E. Çelebi, *Seyahatname...*, c. VIII, f. 711.

²⁵ , f. 109. Vetëm dy vite më pas, në vitin 1895 vërejmë se popullsia e qytetit ka arritur shifrën e 4800 banorëve, prej të cilëve 3112 ishin myslimanë, 1478 ortodoksë, 210 katolikë dhe 43 të huaj (siç duket, popullsia e huaj nuk është përlogaritur në numrin e banorëve të qytetit). Shih: *Salnamesi (1312)...*, f. 114.

dy porta, prej të cilave e para shihte nga Lindja duke u hapur drejt Elbasanit, ndërsa tjetra hapej nga Perëndimi dhe ishte porta që të çonte në skelë. Të gjitha shtëpitë që ndodheshin brenda kalasë ishin të ulëta dhe të mbuluara me tjegulla.²⁶ Për arsye se nëntoka kishte shumë kripë, Çelebiu shprehet se këtu nuk kishte bahçe e gjelbërim të madh.

Kalaja kishte një rëndësi të veçantë pasi së pari qe një pikë e fortifikuar, e cila ishte më vështirë të sulmohej dhe, së dyti ajo ishte e populluar. Për këtë arsye, me vendosjen e sundimit të ri, këtu do të ngriheshin edhe ndërtesa të tjera, të cilat do të ishin në përdorimin e drejtuesve të qytetit. Kështu, si njëri prej institucioneve kryesore të funksionimit të rendit, mësojmë se gjykata gjendej brenda kalasë. Ajo çka e vërteton këtë është një kërkesë e banorëve të Durrësit në vitin 1040 Hixhri (1630-31) sipas së cilës deri në këtë kohë gjykata kishte qenë brenda kalasë, ndërsa tani atë e kishin zhvendosur në një vend tjetër jashtë kalasë. Për pasojë njerëzit e kishin të vështirë të shkonin atje sa herë kishin punë, prandaj Stambolli e urdhëron kadiun e Durrësit që gjykata të zhvendoset në vendin e mëparshëm, pra brenda kalasë.²⁷

Një lloj ndërtese tjetër që hasim brenda kalasë pas marrjes së saj prej osmanëve është edhe xhamia. Burimet historike na tregojnë për ekzistencën e dy xhamive brenda kalasë së Durrësit, xhaminë Fatih Sulltan Mehmed Han dhe xhaminë Kaça Hanim.²⁸ Për të dytën nuk kemi të dhëna të tjera përveç atyre që kalojnë tek Ayverdi, ndërsa për xhaminë e Mehmedit II hasim edhe në dokumenta arkivore. Kështu, në një shkresë që mban datën 25 mars 1866 jepet leja për meremetimin e kësaj xhamie, shpenzimet e së cilës do të përballoheshin prej vakëfit të Sulltan Mehmed Fatihut.²⁹

Padyshim që garnizoni i ushtarëve të ngarkuar me detyrë për mbrojtjen e kalasë qe edhe pika më e fortë tek e cila mbështetej siguria e

²⁶ *Po aty.*

²⁷

-1631 (1631)) (Özet,

²⁸ Për monumentet e tjera osmane që Ayverdi ka evidentuar si brenda kalasë së Durrësit ashtu edhe në pjesën jashtë saj, pra në Varosh, shih: Ekrem Ayverdi,

gjithashtu shih: Aleksandër Meksi, *Xhamitë e Shqipërisë: Historia, Arkitektura, shek. XV-XIX*, Tiranë: AIITC, 2015, f. 162.

²⁹ *Osma*

kalasë dhe banorëve brenda saj. Në shumë komunikime që vërejmë të jenë kryer me Stambollin hasim urdhra për mbrojtësit e kalasë së Durrësit për të qenë vigjilentë karshi sulmeve të anijeve pirate.³⁰ Prandaj edhe çështja e shlyerjes së detyrimeve dhe e shpërblimit merrte një rëndësi të veçantë. Nga burimet mësojmë se pagesa e tyre realizohej në mënyra të ndryshme. Përveç parave apo pronave e koncesioneve, ka edhe raste kur në mungesë të parave atyre u jepej kripë, të cilën më pas e tregtonin për të fituar të ardhura.³¹ Madje, për të evituar ndonjë pakënaqësi apo rebelim të ushtarëve, në rast se do të kishte ndonjë vonesë në pagesat e tyre, gjë e cila ishte normale po të kihet parasysh fakti se këto ishin zona periferike, duke mbërritur.³²

Mbi rendin dhe sigurinë e qytetit

Ashtu si të gjitha qytetet bregdetare të Mesdheut edhe Durrësi e kishte ndjerë përherë kërcënimin e anijeve pirate. Për këtë arsye mbrojtja e qytetit ishte një prioritet për qeveritarët osmanë të tij. Përveç fortifikimeve të kalasë ekzistuese, ngritjen brenda saj të një fortifikimi të dytë, brenda së cilës kryesisht qenë vendosur selitë e institucioneve administrative dhe pozicionimit të një garnizoni rojesh, fakti që Durrësi në veçanti dhe hapësira shqiptare në përgjithësi pozicionohej në periferi të Perandorisë Osmane dhe kufizohej me një rival të rëndësishëm ekonomik e ushtarak siç qe Republika e Venedikut, e kishte detyruar Stambollin dhe administratorët osmanë të Rumelisë të ndërmerrnin edhe hapa të tjera shtesë për sigurimin e brigjeve, në rastin konkret, Durrësit.

Kështu, përveç trupave të Elbasanit nga e cila varej kazaja e Durrësit, në raste luftërash apo kërcënimesh të mëdha, ishin urdhëruar edhe sanxhaqe të tjera që të dërgonin trupa për mbrojtjen e kësaj pike bregdetare. Për shembull, në vitin 1565, kohë kur osmanët qenë të

³⁰ , f. 286.

³¹ Në vitin 1630 vërejmë të jetë bërë një kërkesë që ushtarëve të kalasë së Durrësit, të

posedonin me dyfishin e çmimit, në mënyrë që ky të ishte një lloj shpërblimi për ta. Por, nga Stambolli ishte urdhëruar që edhe kripa e këtyre ushtarëve të blihej me çmimin e tregut. Shih: 85 Num , f. 286.

³² -976/ 1567-1569) (Özet, Transkripsiyon ve

angazhuar në fushatën ushtarake të Maltës, përkundër një sulmi të mundur të armiqve në drejtim të kalasë së Durrësit, mbrojtja e saj i ishte ngarkuar sanxhakbeut të Elbasanit dhe spahinjve që kishte nën urdhra.³³

Në vitin 1530 mësojmë se, me ruajtjen e kalasë së Durrësit qenë të imam e hatip, 20 topçinj e xhebexhinj, 32 roje, një aga dhe 199 azepë.³⁴ Siç do ta shohim edhe më poshtë, pagesa e tyre bëhej në mënyra të ndryshme porse gjatë shek. XVI vërejmë se më së shumti atyre iu qenë shpërndarë timare. Kështu, trupat e kalasë së Durrësit posedonin si timare 9 fshatra në kazanë e Elbasanit, 2 fshatra dhe një mezra në kazanë e Shpatit dhe 36 fshatra në kazanë e Durrësit duke arritur që së bashku me ullufet, kjo trupë rojesh të kishte në total një shumë vjetore të ardhurash prej 451.948 akçesh.³⁵

eksponuara brigjet shqiptare karshi sulmeve nga deti. Në vitin 1570, Stambolli urdhëronte kadilerët e Janinës, Vlorës e Durrësit që të merrnin masa për sigurimin e vendbanimeve të tyre në afërsi të bregdetit për arsye se ishin marrë informacione për lëvizjen e anijeve të armikut në afërsi të brigjeve.³⁶ Madje, edhe beut të Kjustendillit i urdhërohej që të dërgonte 200 spahinj me përvojë nga sanxhaku i tij, me detyrën e mbrojtjes së Vlorës e të Durrësit.³⁷ Kjo pasi anijet armike tani përbënin një kërcënim serioz dhe kishin sulmuar skelën e Lezhës (Shëngjinit) duke marrë peng eminin, qatipin dhe disa ushtarë.³⁸ Informacionet e marra ishin të sakta. Më 12 prill 1571 një numër i madh anijesh do të qëndronin përpara Durrësit ku, një pjesë e tyre vunë nën shënjestër murin rrethues të kalasë.

³³ / 1564- , I,

Ankara: 1995, f. 217.

³⁴ -i Vilayet-i Rum-
ri (926-1520/ 937-1530)

-33.

³⁵ -i Vilayet-i Rum-ili Defteri..., f. 33.

³⁶ -979/ 1570-1572) (Özet, Transkripsiyon ve

³⁷ -978/1569-1570) (Özet ve
Transkripsiyon)

2006, f. 113.

³⁸ , I, f. 62.

Si rrjedhojë e kundërpërgjigjes së trupave mbrojtëse, dy galeota të armikut ishin goditur me topa.³⁹ Rreth dy muaj më pas, në qershor të të njëjtit vit, agai i azepëve të Vlorës i dërgonte letër Stambollit ku shprehet se rreth 110 galeota, 60 barka dhe 2 galionë spanjollë u ishin drejtuar brigjeve të Vlorës ndërsa një numër anijesh veneciane kishin sulmuar Durrësin duke theksuar se mbeteshin vigjilentë karshi zhvillimeve.⁴⁰ Siç duket, përkundër rrezikut vazhdimisht në rritje, në një shkresë të dërguar nga Stambolli për sanxhakbeun e Ohrit, Hasan Beun, i urdhërohet këtij të fundit të qëndrojë në gatishmëri dhe, nëse do të lindë nevoja të shkojë për të mbrojtur kalanë e Durrësit.⁴¹ Jo vetëm trupat mbrojtëse të kalasë së Durrësit dhe trupat ushtarake të sanxhakut të Elbasanit por, për mbrojtjen e këtij fortifikimi bregdetar qenë ngarkuar me detyrë edhe ajanët e zanatçinjtë e Elbasanit. Këtë gjë e mësojmë nga një ankesë e këtyre të

grumbu

grupet në fjalë shprehen se kanë urdhër perandorak, i cili u ngarkon detyrën e mbrojtjes së kalave të Bashtovës e Durrësit në rastin e një sulmi të mundshëm venecian.⁴²

Rreth tre dekada më vonë, trupat spanjolle të drejtuara nga markezi Santza Kruz, natën që lidhte 3 me 4 gushtin e vitit 1606, me rreth 26 galera napolitane të nisura nga Brindisi do të organizonin një sulm mbi qytetin e Durrësit, duke e djegur dhe marrë, sipas burimeve, edhe 155 robër, 40 topa të rëndë, armatime e municione. Burimet perëndimore shprehen se flakët e qytetit në djegie dukeshin 4 milje larg.⁴³ Këto të

³⁹ *Po aty*, f. 211. Dokumenti nuk i referohet faktit se cilit shtet i përkisnin anijet por, në shkresën e mëposhtme të nisur nga Vlora në drejtim të Stambollit, theksohej se ato ishin të Venedikut. Informacioni ka logjikë pasi periudha në fjalë përkon me Luftën e Tretë Osmano-Venete.

⁴⁰ , I, f. 362.

⁴¹ , II, f. 230.

⁴² Për më shumë shih: *Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga shek. XVI deri në fillim të shek. XVIII (dokumente osmane)*, përgatitur nga Selami Pulaha, Tiranë: 1978, f. 103.

⁴³ Burimet tregojnë se 3600 ushtarë zbritën në breg duke e sulmuar qytetin. Ndërsa trupat osmane nuk bënë asnjë rezistencë por u tërhoqën në kështjellë dhe, pas gjyleve të para, u dorëzuan. Shih: Peter Bartl, *Ballkani Perëndimor midis monarkisë spanjolle dhe Perandorisë Osmane: Mbi çështjet e luftës antiturke në kapërcyell të shek. XVI dhe XVII*, përkthyer nga Pëllumb Xhufi, Tiranë: Dituria, 2011, f. 50-51; Pëllumb Xhufi, *Arbërit e Jonit*, botim i dytë, Tiranë: Onufri, 2017, f. 708-709; Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare...*, f. 48.

dhëna jo vetëm tregojnë pamundësinë e zhvillimit ekonomik e demografik të këtij qyteti por, edhe dobësinë fizike të kalasë, e cila ishte e brishtë karshi sulmeve që mund të kishin nga jashtë.⁴⁴ Madje, kjo dobësi e kalasë ishte vënë re edhe prej aktorëve të jashtëm e të brendshëm, të cilët, siç e vërejmë edhe në veprën e Bartl-it, e kanë bërë këtë qytet vazhdimisht qendër të planeve të tyre për çlirimin e hapësirave shqiptare prej sundimit osman.

Përveç spanjollëve, të cilët gjatë shek. XVI-XVII qenë rivalët kryesorë të osmanëve në Mesdhe, edhe venecianët do të tentonin sërish për ta sulmuar qytetin. Kështu, në shtator të vitit 1690, flota veneciane e drejtuar nga kapiten Cornaro, në një formacion luftarak ku merrnin pjesë edhe anije malteze e papale, pasi kishin pushtuar Vlorën e Kaninën, do të tentonte sërish për ta marrë Durrësin por, siç theksojnë burimet, një furtunë e fortë në det i kishte penguar ata të zbarkonin në breg. Për pasojë, kapiteni venecian ishte tërhequr së sulmuari qytetin.⁴⁵ Nga ana tjetër, pas sulmit në Vlorë, edhe osmanët duket se kanë marrë masat përkatëse në Durrës ku, përmes një urdhri dërguar nga Stambolli, mbrojtësi i Shkodrës, Sulejman Pasha tanimë ngarkohej edhe me detyrën e mbrojtjes së Durrësit karshi një sulmi venedikas.⁴⁶

Të gjitha arsyet që u përmendën më sipër kishin bërë që për mbrojtjen e Durrësit, përveç meremetimeve dhe masave të tjera të marra për mbrojtjen e qytetit, të lihej në kala një trupë e përhershme. Nevojat ushqimore të jeniçerëve të këtushëm, të paktën për një kohë të caktuar, me urdhër të Stambollit, dërgoheshin prej sanxhakut të Ohrit. Madje, furnizimi nuk ndërpritej edhe në situata jonormale. Për shembull, burimet dokumentare na bëjnë me dije se gjatë vitit 1567 ishte ndaluar nxjerrja jashtë sanxhakut të Ohrit e prodhimeve të kësaj zone. Por, në rastin e furnizimeve që duhet të shkonin për jeniçerët e kalasë së Durrësit,

⁴⁴ Burimet perëndimore shprehen se në kohën e sulmit brenda qytetit nuk kishte patur popullsi, pasi ishte stina e punës dhe njerëzit kishin dalë jashtë kalasë për të punuar. Shih: *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë (1603-1621)*, vëll. III, përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989, f. 63-64.

⁴⁵ Mbi fushatën në fjalë shih: P. Xhufi, *Arbërit e Jonit...*, f. 908-911.

⁴⁶ *Qëndresa e popullit shqiptar...*, f. 189-190.

vërejmë që është bërë përjashtim dhe atje janë dërguar materialet e nevojshme.⁴⁷

Jo vetëm sulmet dhe kërcënimet nga deti por edhe problemet e rendit brenda kazasë së Durrësit na japin të dhëna interesante për problemet që kjo hapësirë haste në këtë periudhë. Këto probleme mund

mospagesë taksash, plaçkitje dhe krime të rëndomta, ndërsa në të dytën futen abuzime të qeveritarëve me postin e tyre.

Duke filluar nga gjysma e dytë e shek. XVI, ekonomia e qyteteve shqiptare, më konkretisht ata të Shqipërisë Qendrore do të kishin një ringritje e zhvillim ekonomik, i cili natyralisht do të shoqërohej edhe me një gjallërim të aktivitetit tregtar të skelës së Durrësit. Paralelisht me këtë do të shtohet edhe niveli i rrezikshmërisë së rrugëve që të çonin drejt portit, akse në të cilat vazhdimisht qarkullonin karvane mallrash. Në bazë të shqetësimeve të lindura në lidhje me këtë çështje, vërejmë se edhe Stambolli ka marrë masat e duhura duke komunikuar urdhra të ndryshme. Kështu, në korrik të vitit 1560, i dërgohet urdhër sanxhakbeut dhe kadiut të Elbasanit se banditë nga sanxhaku i Ohrit hynin vazhdimisht në hapësirën e juridiksionit të sanxhakut të Elbasanit duke rrëmbyer njerëz e plaçkitur tregtarët përgjatë aksit që të çonte drejt skelave të Durrësit dhe të Lezhës.⁴⁸ Më 1566 banditë nga fshati Bastar mësojmë të kenë kryer plaçkitje në rrugët që të çonin drejt skelës së Durrësit.⁴⁹ Një urdhër të ngjashëm me atë të mësipërmin e hasim edhe aty nga fundi i dhjetorit të vitit 1567 ku, në një urdhër dërguar sanxhakbeut të Ohrit dhe kadiut të Dibrës, thuhet se në rrugët që të çojnë drejt skelave të Durrësit dhe të Lezhës ndodhnin plaçkitje e sulme, të cilat vinin në rrezik mallrat dhe jetët e tregtarëve që kalonin nga këto porte për të vijuar deri në Tetovë e Shkup. Për këtë nevojë, duhet të merreshin të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e këtyre rrugëve.⁵⁰ Në prill të vitit 1566 kërkohet arrestimi i personit të quajtur Muhamed Kyçyk (i vogël) nga fshati Ndroq në afërsi

⁴⁷

, II,

Ankara: 1999, f. 183.

⁴⁸

- 968/ 1558-1560)

Qëndresa e

popullit shqiptar..., f. 52-53.

⁴⁹

Qëndresa e popullit shqiptar..., f. 73-74.

⁵⁰

, I, f. 280.

të Durrësit, i cili kishte bërë vazhdimisht vjedhje e akte dhune. Prandaj i kërkohet sanxhakbeut të Elbasanit arrestimi i tij dhe mbajtja në izolim deri në ardhjen e flotës, ku të hiqet në anije e të dërgohet drejt Stambollit.⁵¹

Çështja e sigurimit të rrugëve dhe mbajtjes së rendit duket se i ka detyruar osmanët të ndërmerrnin hapa edhe më drastikë. Një i tillë që zhvendosja e disa fshatrave, të cilat gjendeshin në terrene malore e që shpeshherë rebeloheshin ose sulmonin vende të ndryshme, duke i përqendruar banorët e tyre në fusha. Për shembull, në tetor të vitit 1564, Stambolli urdhëron sanxhakbeun e Elbasanit të ndërmarrë masa kundër krerëve të banorëve të katër fshatrave që vareshin nga kazaja e Durrësit, në mesin e të cilëve gjendej edhe fshati Katesh, banorët e të cilëve largoheshin nga fusha ku gjendeshin vendbanimet e reja në drejtim të atyre të mëhershme⁵² për të organizuar më pas sulme e bastisje në zonat përreth, deri në Myzeqe.⁵³

Një fshat tjetër kryengritës që varej nga kazaja e Durrësit dhe, siç duket nga dokumentet, kishte qenë një problem i madh për rendin, ishte edhe fshati Vrap. Në një shkresë që mban datën 3 korrik 1568, thuhet se, persona të cilët qenë rebeluar prej kohësh bastisnin shtëpitë e çifligjet e zonës, vidhnin dele, vinin prita e nuk i përulleshin urdhrave të Sheriatit. Për këtë arsye, urdhërohet sanxhakbeu i Elbasanit që të merrte masat e nevojshme për dënimin e krerëve të këtij rebelimi.⁵⁴

Pasiguria në rrugët lidhëse që vinin nga brendatoka drejt skelës së e osmanët të meremetnin fortesat e vjetra ose ndërtime të reja. Një rast i tillë është edhe ai i një kalaje që do të ndërtohet në Ishëm aty rreth viteve 1570, por edhe furnizimi me ushtarë i kalasë së Peqinit, e cila gjithashtu gjendej në një nyje të rëndësishme lidhëse. Kështu, në dy urdhra që vinin nga Stambolli në shkurtin e vitit 1574 caktoheshin bejlerbeu i Rumelisë dhe ai i Ohrit që i pari të

⁵¹ , f. 234.

⁵² Sipas një dokumenti që mban datën 5 shkurt 1565, banorët e këtyre fshatrave e kanë r nga vendbanimet e tyre të kahershme. Këtë herë

rezistencës. Shih:

teri (975- 976/ 1567-1569) (Özet,

⁵³ , f. 143.

⁵⁴ , II, f. 247.

mundësonte furnizimin me ushtarë të kalasë së Peqinit, ndërsa i dyti duhej të mblidhte 300 ushtarë nga k fortifikimin e Ishmit, mes të cilëve do të grumbulloheshin 50 ushtarë nga trupa e kalasë së Durrësit dhe 50 të tjerë nga ajo e Lezhës.⁵⁵

Përveç probleme që u përmendën më sipër, një aspekt tjetër që përbënte shkelje dhe të cilin e hasim nëpër dokumenta, është edhe çështja e mospagesës së taksave. Një rast i tillë është edhe ai i disa banorëve të Luzit dhe Gosës, të cilët nuk i kishin paguar taksat që jepnin prej tridhjetë ikur pagesës në fjalë. Me këtë rast, nga Stambolli urdhërohej kadiu i Durrësit që të merrte masat e duhura për verifikimin dhe, në rast se do të duhej, dhënien e dënimit përkatës këtyre personave.⁵⁶

Si një qytet bregdetar, një problem kryesor i rendit dhe sigurisë së Durrësit ishte pirateria. Në dokumentacionin osman hasim çështje, kur, banorë të qytetit u hipin barkave, hapen në det dhe sulmojnë anije të ndryshme tregtare. Një rast të tillë e hasim në vitin 1536 kur ambasadori venecian në Stamboll, Tommaso Mocenigo ishte ankuar pranë Portës së Lartë se dy piratë kishin sulmuar e marrë peng venecianë në Adriatik duke i sjellë pengjet e mbajtur në Durrës. Prandaj, me urdhër të Stambollit, i kërkohet sanxhakbeut të Elbasanit dhe kadiut të Durrësit të hetonin ngjarjen në fjalë dhe të merrnin masat e nevojshme për evitimin e rasteve të tilla.⁵⁷

Në të vërtetë, raste të tilla të piraterisë i hasim në mënyrë të rëndomtë edhe në qytete të tjera bregdetare. Për shembull, kur Çelebiu flet për qytetin e Ulqinit, ai thekson se trima shqiptarë vijnë e iu hipin

anijeve, kthehen e i japin edhe yshyr sanxhakbeut.⁵⁸ Një rast të ngjashëm e hasim edhe në rastin e Durrësit. Kështu, në një dokument të marsit të vitit 1565, Stambolli i shkruan sanxhakbeut të Elbasanit, Shaban Beut se një i afërm i dizdarit të Durrësit, Mustafait kishte marrë me vete njerëz dhe ishte hapur në det duke bërë pirateri. Gjithashtu, ishte provuar se ai gjendej në këto akte për arsye të mbrojtjes që gëzonte prej të afërmit të

⁵⁵ *Qëndresa e popullit shqiptar...*, f. 88-90.

⁵⁶ , f. 168-169.

⁵⁷ , f. 100, 104.

⁵⁸ Evliya Çelebi, *Seyahatname*, cilt. 6, Ahmet Cevdet, Dersaadet , 1314, f. 115-116.

tij, i cili ishte dizdar i kalasë. Për rrjedhojë, i kërkohet sanxhakbeut të Elbasanit që ta arrestojë Mustafain së bashku me personat përgjegjës.⁵⁹

Abuzimet e funksionarëve me postin duken normale po të kihet parasysh fakti se hapësira shqiptare ishte një zonë periferike e Perandorisë Osmane. Në këtë rast, po të kemi parasysh edhe mjetet e komunikimit të kohës, si mbikëqyrja ashtu edhe mundësia e ndërhyrjes së Stambollit bëhej më e rrallë. Për rrjedhojë, edhe rasti i dizdarit të Durrësit nuk është i kufizuar. Kështu, në shtator të vitit 1565, mësojmë se një person i quajtur Mehmed kishte siguruar dokumenta të falsifikuara dhe me këto shkresa kishte arritur të siguronte mbajtjen e postit të agait të azebëve të Durrësit. Me pikasjen e falsifikimit, nga qendra i kërkohet beut të Elbasanit që again në fjalë ta arrestonte dhe ta dërgonte për në Stamboll.⁶⁰ Sërish në lidhje me falsifikimet, në vitin 1630 hasim një ankesë nga Durrësi në drejtim të Stambollit, sipas së cilës disa njerëz, pa patur shkresë prej dizdarit të kalasë, kishin përgatitur vërtetime sikur janë trupa mbrojtëse të kalasë së këtij qyteti dhe, megjithëse nuk e kryenin këtë detyrë, ata përfitonin nga koncesionet që u jepeshin mbrojtësve të kalasë.⁶¹ Me këtë rast u dërgohet urdhër sanxhakbeut të Elbasanit dhe kadiut të Durrësit që të marrin masat e duhura për situatën.

Një rast tjetër abuzimi e hasim edhe dy vite më pas ku, në një shkresë tjetër të tetorit të vitit 1567, dërguar nga Stambolli për sanxhakbeun dhe kadiun e Selanikut, urdhërohet që vetë ata të dy të vihen në krye të një trupe inspektimi duke shkuar në drejtim të Elbasanit ku, kadiu i këtij qyteti por edhe rajatë e kazasë së Durrësit janë ankuar se sanxhakbeu i tyre dhe njerëzit që ka nën urdhra kanë dhunuar popullsinë e thjeshtë.⁶²

Një rast tjetër abuzimi me detyrën ishte edhe ai i spahiut të quajtur Mahmud Hasan, pjesëtar i regjimentit të 35 me pagesë prej 30 asprash. Të gjithë funksionarët e lartë të Durrësit, përfshirë këtu imamin, hatibin, again dhe qahjain e kështjellës, në korrik të vitit 1615 i ankoheshin sulltanit për spahiun në fjalë duke theksuar se ai kishte abuzuar me

⁵⁹ , f. 430; *Qëndresa e popullit shqiptar...*, f. 63- 64.

⁶⁰

⁶¹ , f. 286- 287.

⁶² -976/ 1567-1569) (*Özet, Transkripsiyon ve*

popullsinë e varfër, plaçkitur e vjedhur dhe kishte kryer para disa vitesh edhe vrasjen e dy vëllezërve të tjerë spahinj si dhe shumë krimeve të tjera.⁶³ Vetë sulltani urdhëronte kapjen e personit në fjalë dhe dërgimin e tij drejt Stambollit për të kryer dënimin.

Mbi ekonominë e Durrësit gjatë dy shekujve të parë të sundimit osman

Siç u pa edhe më sipër, Durrësi e kishte kaluar shek. XVI dhe fillimin e shek. XVII me sulme, trazira, sëmundje e probleme të shumta, të cilat kishin ndikuar edhe në aspektin ekonomik të këtij qyteti. Me një klimë të papërshtatshme, popullsia të vogël, me ankthin e një sulmi të mundshëm që mund të vinte nga deti dhe me plaçkitjet që kishte pësuar në mënyrë të vazhdueshme⁶⁴, Durrësi nuk po ecte me hapin e qyteteve shqiptare të kohës si Elbasani, Berati, Vlora, Shkodra, madje edhe Korça, të cilat kishin hyrë në një fazë të vrullshme të zhvillimit ekonomik e urban.

Megjithëse me skelë të dëmtuar vazhdimisht nga sulmet, dokumentacioni arkivor na tregon se aktiviteti i import-eksportit i portit të Durrësit kishte vijuar të ishte funksional.⁶⁵ Për shembull, në një dokument të vitit 1607 mësojmë se një kalorës kishte lundruar me dy anije të vogla që nisur drejt brigjeve lindore të Adriatikut, veçanërisht edhe Durrësit, me pretekstin për të sjellë këtu robërit e kapur gjatë sulmit të një viti më parë dhe, në kthim për të ngarkuar grurë e misër në anijet e

⁶³ , f. 311-312.

⁶⁴ Këtë element e parashtron më së miri një konstatim i Shuflajt, i cili shprehet se gjatë një periudhe katër shekullore (992-1392), pra deri në marrjen e qytetit prej venecianëve, Durrësi kishte ndërruar zot plot 31 herë. Shih: Milan Shuflaj, *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë, kryesisht në Mesjetë*, përgatiti për botim Luan Malltezi, Tiranë: Onufri, 2009, f. 9. Këtë gjë e përforcon edhe një projektrelacion i Nikolla Mekajshit dërguar Klementit VIII në vitin 1603, ku ai shprehet se marrja e Durrësit ishte e lehtë pasi qyteti kish qenë plaçkitur edhe më herët prej spanjollëve dhe se distanca e afërt me Puljen e Sicilinë e mundësonte mbrojtjen e këtij vendi. Shih: *Dokumente të shekujve XVI-XVII...*, f. 45.

⁶⁵ Megjithatë skela vërejmë të mos ketë patur ndonjë aktivitet të theksuar ekonomik. Këtë aspekt e vërejmë edhe në Kanunamenë e sanxhakut të Elbasanit të vitit 1568 ku taksa e doganës së skelës së Durrësit ishte në të njëjtën vleftë me atë të Bashtovës. Për më shumë shih: Dritan Egro, *Ligji osman ndër shqiptarët e mesjetës së vonë*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2012, f. 174.

tij.⁶⁶ Nga një dokument tjetër mësojmë se në vitet 1618, në grykëderdhjen e Erzenit mbusheshin anije me grurë.⁶⁷

Në lidhje me tregtinë e jashtme të Durrësit gjatë gjysmës së parë të shek. XVII na informon edhe një dokument i vitit 1626, i cili përmban një vendim të senatit të Venedikut ku propozohet lehtësimi i procedurave të blerjes së pëlhurave nga raguzianët. Kjo, për faktin se nëse ata nuk do

mallra në mënyrë kontrabandë dhe pa paguar taksën dog shitur më pas në Durrës apo Vlorë.⁶⁸

Në aspektin e tregtisë së brendshme dhe zanateve që ushtroheshin në qytetin e Durrësit nuk kemi shumë të dhëna. Fakti që nuk përmendet në mesin e qyteteve shqiptare të cilat kishin grupe esnafore, na bën të mendojmë se prodhimi vendas dhe zejtaria e këtij qyteti nuk qe shumë e zhvilluar. Siç duket, nevoja të tilla kryheshin prej esnafëve të qyteteve përreth. Kështu, në vitin 1606 argjendarët e Elbasanit ankoheshin tek kadiu se disa kolegë të tyre, në kundërshtim me rregulloret përkatëse, e ushtronin këtë zanat në zona e qytete të ndryshme, në mesin e të cilëve ishte edhe ai i Durrësit.⁶⁹

Aty nga mesi i shek. XVII, Çelebiu e përmend Durrësin si një vend ku prodhohej dhe eksportohej sasi e madhe kripe e cila tregtohej deri në pjesët e brendshme të Ballkanit por edhe më gjerë. Madje, kur nis shpjegimin e kalasë, ai theksonte se kjo ndërtesë ngrihej sipër një

⁷⁰ Gjithashtu, edhe porti i këtij qyteti kishte një pozitë të veçantë ku, në të ankoroheshin anijet që tregtonin produktet e tregtarëve të mëdhenj të sanxhakut të Elbasanit. Ky aspekt, në fakt përbënte edhe shkakun e zhvillimit dhe funksionimit të skelës së Durrësit, i cili duke përfituar nga rritja e madhe e potencialit ekonomik të Elbasanit, jo vetëm që thithte produktet e këtij tregu por, gjithashtu edhe të një aksi më të madh ekonomik-tregtar që shkonte deri në Manastir e Ohër.

Me rritjen e hegjemonisë osmane edhe në Adriatik dhe zgjatjen e saj në brigjet e Dalmacisë, gjithashtu edhe me rritjen e prodhimeve në

⁶⁶ *Dokumente të shekujve XVI-XVII...*, f. 179.

⁶⁷ , f. 333.

⁶⁸ *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653)*, transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputi, Faik Konica, Prishtinë 2015, f. 57-58.

⁶⁹ Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare...*, f. 229.

⁷⁰ E. Çelebi, *Seyahatname...*, c. VIII, f. 711.

hapësirën e Rumelisë do të bënin që aktiviteti ekonomik me Europën të rritej, duke rritur në këtë mënyrë edhe rolin e qytetit të Durrësit, i cili tanimë do të kthehej në një skelë të rëndësishme import-eksporti. Në depot e këtij porti, sipas burimeve të kohës, thuhet se mbledheshin mallrat e tregtarëve nga Ohri, Korça e Voskopoja, për të përfshirë edhe ato të elbasanasve e qendrave të tjera të Shqipërisë së Mesme. Për rrjedhojë, aty nga fundi i shek. XVII në portin e Durrësit gjejmë të ankoruara anije ulqinake, franceze, holandeze, raguzane, veneciane e angleze.⁷¹

Ndër produktet e eksportuara përmes këtij porti përmenden mallra që kanë të bëjnë kryesisht me blegtorinë si lëkurë e lesh, por edhe dyllë e materiale të tjera. Tanimë porti i këtushëm konkurronte edhe me atë të Selanikut. Burimet theksojnë se gjatë gjysmës së dytë të shek. XVII vetëm në skelën e Durrësit punonin rreth njëqind tregtarë shkodranë.⁷² Nëse do të mendohet se përveç këtyre që përmendëm, këtu do të kishte edhe tregtarë nga qytetet e tjera, atëherë potenciali ekonomik e tregtar i Durrësit kishte arritur një zhvillim të madh. Siç duket, kjo rritje e shpejtë

pte 300 talerë pashait të Bosnjës, i cili do të përpiqej për të ndërhyrë tek Porta e Lartë me qëllim mbylljen e portit⁷³, gjë e cila nuk do të ndodhte.

Dy shekujt e parë të Durrësit nën sundimin osman përfundojnë me ndërmarrjen e disa hapave tejet të rëndësishme, të cilat do të rezultojnë si një gur i rëndësishëm kilometrik në zhvillimin ekonomik, kulturor e politik të kësaj qendre urbane; të vendosjes këtu të konsullatave të Anglisë, Francës, Holandës dhe Austrisë. Fushëveprimin dhe impaktin politik e ekonomik që konsullatat do të kishin në Durrës më së miri e përshkruan një letër që konsulli francez i këtushëm, Comte, i dërgonte Parisit:

⁷¹ Për më shumë shih: Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare...*, f. 80-81.

⁷² *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. I, f. 557.

⁷³ në qoftë se nuk do të mbyllet me kohë limani i Durrësit, i cili jo vetëm kthehet në dëmin tonë, por edhe në atë të Zotërisë së tij të shkëlqyer [pra, të Bosnjës] sepse ai mbetet pa ato të ardhura që do të nxirrte gjerësisht këtu në Raguzë nga mallrat që me
Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. II, përgatitën për botim Injac Zamputi, Stavri Naçi, Zija Shkodra, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1962, f. 153-154. Bashkë me atë të Durrësit, Raguzë kishte kërkuar edhe mbylljen e portit të Vlorës. Shih: Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare...*, f. 81.

Madhëria e juaj të më lejoni të ju bëj një shënim të vogël të tregtisë së këtij vendi. Këtu ka rreth 100 tregtarë të cilët janë të gjithë turq (myslimanë) ose grekë (ortodoksë) që banojnë disa në Vëllahi, në Shkodër, Elbasan, Voskopojë, Saqishte, Janinë e Selanik. Të gjithë këta tregtarë së bashku, një herë në vit ngarkojnë për Venedik ku kanë korrespondentët e vet...

*... 3. 000 kuintal dyll, 15. 000 kuintal lesh të hollë dhe pastaj ndonjë parti lëkurë qeshë e buajsh; dhe për kundra-parti, një herë në vit marrin rreth 1.500 topa cohë të Venedikut... e sa për stofrat prej mëndafshi, një herë në vit zbarkohen 5 ose 6 arkë, të cilat çohen në Edrene duke mos pasë asnjë shitje në këtë krahinë të Shqipërisë.*⁷⁴

S u m m a r y

CHARACTERISTICS OF A BORDERING TOWN: DURRËS DURING THE FIRST TWO CENTURIES OF THE OTTOMAN RULE (16TH-17TH CENTURIES)

As one of the oldest and at the same time one of the most important towns of the Albanian space and beyond, Durrës went through a difficult period at the beginning of the Middle Ages. Apart from the extremely bad climate which

. The disgraceful situation of the town, before it was occupied by the Venetians, was described by Shuflaj who stated that in 400 years Durrës had changed masters 31 times. In this bad situation the town was taken over by the Sanjak bey of Elbasan, Mehmet Bey, in 1501.

The lack of an essentially historical study on the history of Durrës under Ottoman rule, makes it impossible to have a detailed view of the order, society,

main reason for this study which makes an attempt to present a view of Durrës during the first two centuries of the Ottoman rule. The documents of Western and Eastern archives portray Durrës with all the obstacles, developments and transformations of a bordering town, which is located at the borderland not only of countries but also empires, philosophies and civilizations. These elements are clearly reflected in the events that characterize the town during two

⁷⁴ *Burime të zgjedhura...*, f. 154-155.

centuries during which it attempted to regain its energy and previous glow. Once the international balance was established, the town entered a period of tranquility and with the opening of foreign consulates Durrës seemed to start recovering after seven or eight centuries.

